



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË / OSNOVNI SUD MITROVICA

AD.GJTHM.nr.04/23

GJYKATA THEMELORE MITROVICE, Nënkryetari i Gjykatës Bekim Veliqi, duke vendosur ne çështjen disiplinore të ngritur ndaj V.F, Gjyqtare pranë Gjykatës Themelore Mitrovicë-Dega në Vushtrri-Divizioni civil, duke vepruar sipas ankesës disiplinore te parashtruar nga përfaqësuesi i propozues G.A-A av.V.H nga Prishtina, pas vlerësimit te ankesës së parashtruar nga përfaqësuesi i propozues dhe pranimit të deklaratës së Gjyqtares V.F, në vlerësim të shkresave të lëndës, në mbështetje te nenit 9 par.6 te Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokuror dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 25.05.2023, merre këtë;

A K T V E N D I M

REFUZOHET Ankesa disiplinore e dt.12.05.2023, e regjistruar me numër të lëndës AD.GJTHM.nr.04/2023, e parashtruar nga përfaqësuesi i propozues G.A-A av. V.H nga Prishtina, kundër Gjyqtares **V.F**, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtrri-Divizioni civil, e **PA BAZUAR**.

Arsyetim

Në cilësinë e Nënkryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, me dt.12.05.2023, kam pranuar ankesën nga përfaqësuesi i propozueses G.A-A av. V.H nga Prishtina, kundër V.F, Gjyqtare në Gjykatës Themelore Mitrovicë –Dega në Vushtrri-Divizioni civil.

Përfaqësuesi i propozues G.A-A, av.V.H, në ankesë ka ngritur çështjen e vendimmarrjes ne lenden e caktuar te gjyqtares V.F, e cila ka refuzuar me aktvendim C.nr.480/23 të dt.20.04.2023 propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

Përfaqësuesi i propozues G.A-A av. V.H, në ankesë cekë se pasi që propozimi për masën e përkohshme të sigurisë është vendos sipas lëndës C.nr.465/23 të dt.31.03.2023 ku i është refuzuar propozim, duke ja mohuar pronares të drejtën subjektive për të pas siguri lidhur me procesin e zhvillimit sipas padisë av.V.H duke u bazuar në parimin se Gjykata nuk mund të thirret në parimin „çështje e gjykuar ose res juridika” i është drejtuar prap gjykatës me propozim për masën e përkohshme te sigurisë, e cila lëndë ishte për shqyrtim tek gjyqtarja V.F.

Sipas përfaqësuesit, gjyqtarja e çështje i kishte të gjitha provat për ta vendosur masën e përkohshme të sigurisë në favor të propozues, mirëpo gjyqtarja veproj jo në proporcion me nenin 297 par.1 pika a) dhe b) të LPK-së dhe tani uzurpatori ndihet i lirë në uzurpim dhe thirret dhe mbështetet në aktvendimin e tillë. Uzurpatori A.A pasi u cilësua se nuk qenka uzurpator sipas aktvendimit (te marre nga Gjyqtari I. G) C.nr.465/2023, ka marrë forcën dhe me dt.25.04.2023 në qytetin e Vushtrrisë në qytetin e Vushtrrisë bashkë me vëllain e tij, e kanë kërcënuar me jetë, për çka edhe ka hapur rast ndaj tij.

Autoriteti kompetent ne rastin konkrete, ka marre veprime procedurale pas pranimit te ankesës, ka inicuar procedurën disiplinore ndaj subjektit te hetimit-gjyqtares, e cila gjyqtare ka dhënë deklarat me

shkrim, lidhur me ankesën e përfaqësuesit të propozueses G.A-A av.V.H, ka theksuar se propozuesja përmes të autorizuarit të saj me dt.12.04.2023, ka paraqit propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit të cilën e ka pranuar me dt.14.04.2023, propozimin e kam kthyer për plotësim, me date 20.04.2023, e kam pranuar parashtrësën e përfaqësuesit sa i perkte plotësimin, kundër kundërshtarit A.A nga fshati ..., Komuna Vushtrrisë parcelat katastrale nr.00588-0 dhe 00589-0 që të dyja ngastra në fshatin ...,Vushtrri.

Pas shqyrtimit të kërkesë së propozueses kërkesa si e tillë është konsideruar e pabazuar dhe është vendosur me aktvendim C.nr.480/23, të dt.20.04.2023, me të cilin aktvendim i është refuzuar kërkesa për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë dhe ndalimin e shitjes dhe tjetërsim të parcelave katastrale P-00588-0 dhe P-00589-0 kundër kundërshtarit të masës së përkohshme të sigurimit A.A, për shkak se kundërshtari i masës A.A, i cili në aspektin ligjor nuk mund ti shes apo të tjetërsoj pa qenë pronar si rrjedhojë edhe kërkesa e propozueses e parashtruara nga përfaqësuesi i autorizuar është refuzuar. Gjyqtarja e çështjes, në deklaratën e dhënë ka theksuar se pas analizimit të anekses së parashtruar nga përfaqësuesi ka konstatuar se nuk ka asnjë pretendim konkrete në lidhje me shkeljet eventuale të rregullave të etikës, por e njëjta ankese në tërësi është shfaqje e pakënaqësisë në lidhje me mënyrën e vendosjes e jo që tregon shkeljet konkrete disiplinore, dhe mbi këto arsye nuk qëndrojnë asnjë pretendim për shkelje disiplinore, andaj në bazë të lartcekurave rrjedh që ankesa të refuzohet e pabazuar

Andaj autoriteti kompetent ka konstatuar se ankesa si e tillë është e pabazuar, pretendimet për shkeljet konkret të Ligjit për Përgjegjësisë disiplinore për Gjyqtar dhe Prokuror, janë të pa qëndrueshme, nuk kemi asnjë dyshim të qëndrueshëm për veprime të mëtejme procedurale në raport me subjektin e hetimit, duke marrë për bazë edhe përgjigjen e marrë nga gjyqtarja ndaj të cilit është ngritur procedura disiplinore, e cila në mënyrë përmbajtësore ka shpjeguar veprimet e ndërmarra lidhur me lëndën C.nr.480/23 dhe arsyet e refuzimit të kërkesës për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë dhe ndalimin e shitjes dhe tjetërsim të parcelave katastrale pasi që kundërshtari i masës në aspektin ligjor nuk mund ti shes apo tjetërsoj pa qenë pronar i tyre, se çështja e vendosjes lidhur me lëndën i përket gjyqtarit të çështjes pakënaqësitë e palëve të marrja e vendimit nga ana e Gjykatës si shkallë parë, nuk mund të konsiderohen edhe shkelje disiplinore.

Janë të paqëndrueshme deklaratimet në ankesën disiplinore se me veprimet e tij gjyqtari në lëndën C.nr.465/23 I.G) i ndihmoj uzurpatorit të ndihet i lire në uzurpim dhe tani uzurpatori thirret dhe mbështetet në aktvendimin e tillës se nuk ka qenë uzurpator. Çështja dhe emërtimi i fjalës uzurpim i përket procedurës penale dhe nga shkresat e lëndës vërtetohet se me dt.04.04.2023, përfaqësuesi i palës av.V.H, pranë Prokurorisë Themelore Mitrovice ka parashtruar kallëzim penal ndaj të pandehurit A.A, për veprën penale Uzurpim i paligjshëm i pronës së huaj nga neni 320 par.2 të KPRK-es dhe të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 të KPRK-es, veprim të cilën e mbështesim si e drejtë e palës, për të cilën në vlerësojmë se Prokuroria do të veprojë në shqyrtim të këtij kallëzimi penal, çështja e pronës përveç që është çështja ligjore është edhe kategori kushtetuese sipas nenit 46, 121 të Kushtetueses së Republikës së Kosovës, e drejta e pronës është e garantuar.

Asnjë person autoritet tjetër nuk e ka të drejtën e ushtrimit të ndikimit të gjyqtarit me rastin e vendosjes së kërkesave nga palët në procedurë, vendosja e përket gjyqtarit si e drejtë ligjore gjithmonë duke u bazuar në prova dhe palët për pakënaqësitë e tyre e kanë mundësinë ligjore të ushtrimit të mjeteve juridike, marrja e një vendimi nga gjyqtari nuk mund të referohet në nxjerrjeje të paligjshme të vendimit, pasi që ekzistojnë shkallëshemrite për shqyrtimin e vendimeve gjyqësore mbi ligjshmërinë apo paligjshmërinë e tyre me rastin e vendosjes.

Nga arsyet e theksuara me larte, ne mbështetje te nenit 9 par.6 te Ligjit mbi Përgjegjësitë disiplinorë te gjyqtarëve dhe prokuroret dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 te Rregullore per Procedurën Disiplinore te Gjyqtareve, u vendos si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
AD.GJTHM.nr.04/2023, dt.25.05.2023

Nënkryetari i Gjykatës
Bekim Veliqi

Aktvendimi i dërgohet;

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës**
- 2. Parashtruesit av.V.H**
- 3. Gjyqtares V.F**